



VENDIM
K.P.P. 131/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.03.2018, shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

-Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të BOE “Instituti Dekliada-Alb” sh.p.k. & “DERBI-E” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Hartim i projekt-preventivit të objektit : “Furnizimi me ujë i Tiranës nga burimi i Gurit të Bardhë dhe shtimi i prodhimit të energjisë në Hecet”, me nr. REF-31045-10-24-2017, me fond limit 32,000,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.11.2017, nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.

-Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të BOE “E.B.S” sh.p.k & “TAULANT” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

BOE “INVICTUS” sh.p.k & “C.E.C GROUP” sh.p.k & “LENI-ING” sh.p.k.
Adresa: Njësia nr.9, Rr. “Don Bosko”, Pall. “Aurora Konstruksion”, sek.4, kati 3, Ap.1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.
Adresa: Rruga “5 Maj”, pranë Medresesë, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga BOE ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, BOE ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. BOE ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të BOE ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 25.10.2017, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “*Hartim i projekt-preventivit të objektit : "Furnizimi me ujë i Tiranës nga burimi i Gurit të Bardhë dhe shtimi i prodhimit të energjisë në Hecet"*”, me nr. REF-31045-10-24-2017, me fond limit 32,000,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.11.2017, nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.

II.2 Në datën 21.11.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 18.12.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|--|-------------------------------|
| i. “E.B.S” sh.p.k & “TAULANT” sh.p.k. | 19,800,000 lekë, kualifikuar; |
| ii. “Instituti Dekliada-Alb” sh.p.k. & “DERBI-E” sh.p.k. | 25,599,999 lekë, kualifikuar; |
| iii. “INVICTUS” sh.p.k & “C.E.C GROUP” sh.p.k & “LENI-ING” sh.p.k. | 28,832,770 lekë, kualifikuar; |

II.4. Në datën 22.12.2017, BOE ankimues “INVICTUS” sh.p.k & “C.E.C GROUP” sh.p.k & “LENI-ING” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertave të BOE “Instituti Dekliada-Alb” sh.p.k. & “DERBI-E” sh.p.k. dhe BOE “E.B.S” sh.p.k & “TAULANT” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më posht vijon:

“[...]Referuar renditjes përfundimtare të A.K. në sistemin e APP-së konstatohet se ofertat e dorëzuara nga Bashkimet e Operatoreve Ekonomike respektive “E.B.S”sh.p.k dhe “INSTITUTI DEKLIADA-ALB”sh.p.k nuk plotësojnë këtë pike të DST. Vlera minimale e lejuar për ofertimin e shërbimit të projektimit sipas V.K.M. Nr.354 datë 11.05.2016 është 28,832,769.504 lekë pa TVSH. Shënim; Bazuar në shkresën e APP-së Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017, konkretisht sipas pikes 1 të këtij udhëzimi “...fondi limit për llogaritjet nisur nga përqindja maksimale e lejuar... ” të cilës i korespondon fondi limit maksimal 32,000,000 lekë pa TVSH, vështirësinë gjeologjike të trasesë, vështirësinë e ndërtimit të tunelit dhe punimet në Hec-in Lanabregas sipas relacionit teknik dhe gjurmës së objektit sipas variantit 3 në hartën e ngarkuar në sistem nga A.K ky shërbim kategorizohet në Kreun 3, Seksionin 3, Nenet 34, 36, 38 në Grupin Tarifor të 5-të. Autoriteti Kontraktor me kualifikimin që i ka bërë Bashkimit të Operatoreve Ekonomike respektivë “E.B.S”sh.p.k dhe “INSTITUTI DEKLIADA-ALB”sh.p.k nuk ka respektuar V.K.M. Nr.354 datë 11.05.2016 “...Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim Mbikqyrje dhe Kolaudim”, Shkresat e APP-së me Nr. 5585 Prot. date 25.07.2017 me Lëndë “Rekomandim mbi menyren e percaktimit të tarifave minimale të specifikuara në V.K.M Nr.354 datë 11.05.2016...” shkronja i, pika 3 dhe Shkresa e APP me Nr. 13565 Prot. datë 06.11.2017 me lëndë “Tërheqje Vëmendje”, Ky veprim bie në kundërshtim të plote me udhëzimet dhe rekomandimet e APP-së. Oferta jonë është bazuar në rekomandimin e APP-së dhe VKM. Nr.354 datë 11.05.2017. P.m.v se A.K. nuk i ka dhënë informacion të plotë Bashkimit të Operatoreve Ekonomik drejtuar nga shoqëria “Invictus”sh.p.k., në shkresat me Nr. K-2715 Prot. datë 14.11.2017 dhe Nr. K-3036 Prot., datë 11.12.2017 “Kërkesë për informacion dhe Transparencë”, nga llogaritjet matematikore kemi nxjerrë fondin limit të projekt idesë që i korespondon vlera maksimale e fondit limit 32 000 000 lekë. Bazuar në metodologjinë e ofruar dhe preventivin paraprak të hartuar për këtë objekt, analizën e detajuar të çmimit dhe Ofertën e Çmimit të B.O.E. “INVICTUS & C.E.C GROUP & LENI-ING” sh.p.k. janë të vetmit ofertues që kanë përbushur këtë kriter të vendosur nga A.K. në DST.

Referuar ofertes se çmimit të Bashkimit të Operatorit Ekonomik “E.B.S”sh.p.k. 19,800,000.00 lekë konstatohet se është poshtë kufirit të vlerës anomalisht 21,032,617.89 leke. Autoriteti Kontraktor nuk duhet të kualifikonte një ofertë anomalisht të ulët vetëm me justifikimin se njëh në detaje zonën dhe disponohen materialet e studimeve gjeologjike, topografike dhe hidrogeologjike të zonës nga hartimi i projekteve të tjerë. (referuar komunikimit në rrugë elektronike në sistemin e APP-së).

Ju bëjmë me dije, se nga njohuritë e tregut (edhe shoqëria jonë operon në fushën e hidrocentraleve) se B.O.E “E.B.S.”sh.p.k. nuk ka hartuar projekte zbatimi në gjurmën e objektit të kësaj procedure. Edhe n.q.se B.O.E. mund të jetë duke hartuar një studim për zonën ai duhet të vendos referencat ku është bazuar për projektin e UKT-së. (nga i ka marrë të dhënat e studimeve). Këto referenca mbi projekte që janë pronësi e paleve të treta të cilat kanë të drejtat e tyre të pronësisë për studimet që kanë paguar, e ekspozojnë Autoritetin Kontraktor në procese gjyqësore në të ardhmen për përdorim të paautorizuar të të drejtës së pronësisë. Në gjykimin tonë Autoriteti Kontraktor në asnjë rast nuk duhet të pranojë oferta anomalisht të ulëta dhe aq më tepër studime pronësi e palëve të treta në

hartimin e projektit të zbatimit objekt i kesaj procedure “Furnizimi me uje i Tiranës nga burimi i Gurit të Bardhë dhe shtimi i prodhimit të energjisë në Hecet”.

Bashkimet e Operatorëve Ekonomike nuk plotësojnë kriteret sipas kërkesave të pikës 3.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparëshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit financiare, me vlerë sa 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet.

Kontratat e ngjashme të jene të shoqeruar me vertetimin e realizimit nga autoriteti kontraktor ose me subjekte private të paraqiten faturat përkatëse tatimore të shitjes ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Nga informacioni që disponojmë bashkimi i operatorëve ekonomike të drejtuar nga shoqëritë respektive “E.B.S”sh.p.k dhe “INSTITUTI DEKLIADA-ALB”sh.p.k. pjesëmarrës nuk kanë punë të ngjashme në “Linja kryesore dërgimi në ujësjellës gjatë 3-viteve të fundit dhe për rrjedhojë nuk plotësojnë këtë kriter të DST sipas angazhimit në % dhe ndarjes së punës në kontratën e bashkëpunimit.

Bashkimet e Operatorëve Ekonomike nuk plotësojnë kriteret sipas kërkesave të pikës 3.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat ISO: Çertifikata ISO 9001-2008 (ose ekuivalente); Çertifikata ISO 14001-2004 (ose ekuivalente); Çertifikata ISO 39001-2012 (ose ekuivalente); Çertifikata OHSAS 18001-2007 (ose ekuivalente); leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikatat kërkohej të jenë të vlefshme kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike cdo anëtar i grupit duhet paraqesë certifikatat. Nga informacioni që disponojmë, kriteri i mësipërm nuk plotësohet nga “çdo anëtar” i bashkimit të operatorëve ekonomike të drejtuar respektivisht nga shoqëritë “E.B.S”sh.p.k dhe “INSTITUTI DEKLIADA-ALB”sh.p.k. për rrjedhojë nuk plotësojnë këtë kriter të DST. .

Bashkimet e Operatorëve Ekonomike nuk plotësojnë kriteret sipas kërkesave të pikës 3.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet paraqesë Licensa profesionale të shoqërisë dhe të drejtuesve teknikë për projektim (nga MPPT/MZHU) me kategoritë: Kategoria 3/a; Kategoria 4/c; Kategoria 5/ b, c, e, f ; Kategoria 9/d, e; Kategoria 10/a, d, e. Kandidati/Ofertues i huaj duhet të ekuivalentoj (njësoj), licencën profesionale që disponon, të leshuar nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit. Duke u bazuar në buletin javorë të publikuar nga APP-ja dhe KPP-ja ku operoret kanë marrë pjesë dhe janë s’kualifikuar. Kemi studiuar dokumentat standarte të tenderave për procedurat respektive dhe kemi konstatuar se ata ose nuk i disponojnë këto pika license ose nuk kanë drejtuesit teknik në listëpagesë e cila ka sjellë dhe s’kualifikimin nga këto procedura bazuar edhe në V.K.M., Nr.42 datë 16.01.2008 dhe V.K.M., Nr. 943 datë 28.12.2016. Për këtë arsye ne besojmë se B.O.E nuk i kanë plotësuar këto kërkesa të kërkuara në Shtojcën 7 të DST-ve për këtë procedurë. Bashkimet e Operatorëve Ekonomike nuk plotësojnë kriteret sipas kërkesave të pikës 3.3.4. Numri mesatar i punonjesve të siguruar për periudhën shtator 2016 - shtator 2017 duhet të jetë jo më pak se 20 punonjës në muaj të vertetuar me -Vertetim të leshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numrin i punonjësve për secilin muaj, për periudhën shtator 2016 shtator 2017. -Listëpagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën shtator 2016-shtator2017 shoqeruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetsore. Për periudhën shtator 2016-shtator 2017 kërkohej FDP, listëpagesat dhe numri i punonjësve, Bashkimi i Operatorëve Ekonomike të kualifikuar të drejtuar nga shoqëritë respektive “E.B.S”sh.p.k dhe “INSTITUTI DEKLIADA-ALB”sh.p.k nuk kanë në listëpagesa drejtuesit teknik të shoqërive respektive të angazhuar në këtë procedurë në kundërshtim me; VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”

konkretisht; KREU III, Pika 3, Shkronja c, dhe KREU 7 Pika II. VKM Nr. 943 date 28.12.2016 "Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për Licencimin Profesional të Individëve dhe Personave Juridikë që do të Ushtrojnë Veprimtari në Fushën e Studimit e të Projektimit në Ndërtim dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Zbatimit në Ndërtim" konkretisht; KREU III, Neni 24 Pika I, Shkronja e, Të mos kenë detyrime tatimore të papaguara, si dhe të mos jenë në proces falimentimi apo likuidimi. KREU IV, Neni 41 Pika 1 Shkronja b) Kryen veprimtari pa drejtues teknik/nuk plotëson detyrimet dhe kufizimet, që rrjedhin nga kjo rregullore;

Bashkimet e Operatorëve Ekonomike nuk plotësojnë kriteret sipas kërkesave të pikes 3.3.5 Gjithashtu për efekt të kryerjes së studimit në terësi duke përfshirë impaktin ambiental, studimin gjeologjik dhe hidrologjik të projektit, relizimin e sigurisë rrugore të projektit, ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij me kontratë pune të rregullt dhe CV, inxhinieret si më poshtë: 1. inxhinier Hidraulik; 2. inxhinier Gjeolog; 3. inxhinier Elektrik. Inxhinieret e mësipërm të figurojnë në listëpagesa. Bashkimi i Operatorëve Ekonomike të drejtuar nga shoqëritë respektive "E.B.S" sh.p.k dhe "INSTITUTI DEKLIADA-ALB" sh.p.k nuk plotësojnë kriterin e kërkuar në DST pasi nuk disponojnë të gjithë inxhinierët e kërkuar më sipër në listëpagesa.

Bashkimet e Operatorëve Ekonomike nuk plotësojnë kriteret sipas kërkesave të pikës 3.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentin e metodologjisë së ofrimit të shërbimit. Nisur nga vlerat e ofertave të dhëna nga Bashkimet e Operatoreve Ekonomike respektive dyshojmë se ata nuk e kanë plotësuar këtë kriter për të paraqitur një metodologji të ofrimit të shërbimit dhe krahas saj një preventiv të kostove paraprake të projektit të zbatimit të punimeve nga ku do të llogarisnin oferten e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e studim projektimit konkretisht VKM 354. [...]”

II.5. Në datë 29.12.2017 autoriteti kontraktor i kthen përgjigje lidhur me ankesën, BOE ankimues "INVICTUS" sh.p.k & "C.E.C GROUP" sh.p.k & "LENI-ING" sh.p.k. me anë të shkresës Nr. 3456/1 Prot. datë 21.12.2017., duke mos e pranuar atë.

II.5.1. Në datën 03.01.2018 pala ankimuese "INVICTUS" sh.p.k & "C.E.C GROUP" sh.p.k & "LENI-ING" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Në datën 16.01.2018, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.K-179/1prot., datë 15.01.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionet e kërkuara në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në datën 16.02.2018, me shkresën nr. 12/3 prot., Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar dokumentacion në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Në datën 12.03.2018 me shkresën nr. k-179/3 prot., protokolluar me tonën me nr.12/4, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacioni i paraqitur nga autoriteti kontraktor.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dhe kërkesave të operatorëve ekonomik ankimes,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE ankimes “INVICTUS” sh.p.k & “C.E.C GROUP” sh.p.k & “LENI-ING” sh.p.k., mbi kualifikimin e ofertave të BOE “Instituti Dekliada-Alb” sh.p.k. & “DERBI-E” sh.p.k. dhe BOE “E.B.S” sh.p.k & “TAULANT” sh.p.k. me arsyetimin se *“Referuar renditjes përfundimtare të A.K. në sistemin e APP-së konstatojmë se ofertat e dorëzuara nga Bashkimet e Operatoreve Ekonomike respektive “E.B.S”sh.p.k dhe “INSTITUTI DEKLIADA-ALB”sh.p.k nuk plotësojnë këtë pike të DST. Vlera minimale e lejuar per ofertimin e shërbimit të projektimit sipas V.K.M. Nr.354 datë 11.05.2016 është 28,832,769.504 lekë pa TVSH. Shënim; Bazuar në shkresën e APP-së Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017, konkretisht sipas pikes 1 të këtij udhëzimi “...fondi limit përlllogaritjet nisur nga përqindja maksimale e lejuar... ” të cilës i korespondon fondi limit maksimal 32,000,000 lekë pa TVSH, vështirësinë gjeologjike të trasesë, vështirësinë e ndërtimit të tunelit dhe punimet në Hec-in Lanabregas sipas relacionit teknik dhe gjurmës së objektit sipas variantit 3 në hartën e ngarkuar në sistem nga A.K ky shërbim kategorizohet në Kreun 3, Seksionin 3, Nenet 34, 36, 38 në Grupin Tarifor të 5-të. Autoriteti Kontraktor me kualifikimin që i ka bërë Bashkimit të Operatoreve Ekonomike respektivë “E.B.S”sh.p.k dhe “INSTITUTI DEKLIADA-ALB”sh.p.k nuk ka respektuar V.K.M. Nr.354 datë 11.05.2016 “...Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim Mbikqyrje dhe Kolaudim”, Shkresat e APP-së me Nr. 5585 Prot. date 25.07.2017 me Lëndë “Rekomandim mbi menyren e percaktimit të tarifave minimale të specifikuara në V.K.M Nr.354 datë 11.05.2016...” shkronja i, pika 3 dhe Shkresa e APP me Nr. 13565 Prot. datë 06.11.2017 me lëndë “Tërheqje Vëmendje”.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në Shtojcën e ngrakuar në SPE “Amendament DST” 11 Termat e Referencës, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar: *“Në shtojcën 7, Kapaciteti teknik, shtohet kriteri si më poshtë: 3.3.8 “Operatori Ekonomik duhet te paraqesë oferten ne bazë te Udhëzimit të Agjensisë së Prokurimit Publik Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017, si dhe duke plotësuar të gjitha kërkesat e VKM 354 date 11.05.2016 dhe akteve ligjore ne fuqi.””.*

III.1.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën nr.k-179/3 prot datë 09.03.2018 protokolluar me tonën me nr.12/4 datë 12.03.2018, KPP konstaton se përlllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, nga ky i fundit është bërë, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.*

III.1.3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”* sipërcituar në nenin 1 të tij *“Fusha e Veprimit”* parashikon shprehimisht se: *Ky manual i tarifave vlen për llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet e palnifikimit, projektimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit të kryera nga arkitektët dhe inxhinierët (porosimarrës) të financuara me fonde publike, të financuara me fonde publike, të përfshira në listën e punimeve të këtij manuali.*

Ndërsa në nenin 7 të saj parashikohet shprehimisht se: *Tarifat për shërbimet duhet të jenë në një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale të përcaktuara në këtë manual në përputhje me LPP. Pika 3 e nenit 7 parashikon se: Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim tarifat edhe mund të jenë më të ulëta se sa taifa minimale të specifikuara nga ky manual.*

III.1.4. Në Rekomandimin Nr. 5585 Prot datë 25.07.2017 të APP-së; *“Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyerje dhe kolaudim”, parashikohet si më poshtë:*

- *Per sherbimet e parashikuara ne vendimin e sipercituar (Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016), APP rekomandon qe, krahas perlllogaritjes se fondit limit (i cili perlllogaritet nisur nga perqindja maksimale e lejuar), behet perlllogaritja e vleres minimale te lejuar (e cila perlllogaritet nisur nga p erqindja minimale e lejuar), ne varesi te kategorise dhe grupit tarifar , ku ben pjese objekti i prokurimit*
- *Ne nenin 7, pika 3, te vendimit te sipercituar, parashikohet se: "Ne rrethana te jashtezakonshme dhe nese dokumentohet me shkrim, tarifat edhe mund te jene me te uleta sesa normat minimale, te specifikuara nga ky manual".*
- *Ne kete kontekst rekomandojme qe, ne rastet kur nuk dokurnentohet rrethana e jashtezakonshme, autoritetet kontraktore gjate vleresimit te ofertave, duhet t'i referohen vleres minimale te perlllogaritur per secilin rast, ne haze te parashikimeve ne VKM Nr. 354, date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim".*
- *Ne paraqitjen e ofertave ne kete lloj procedure prokurimi, operatoret ekonomike duhet te mbajne ne konsiderate edhe vlerat minimale te perlllogaritura nga autoritetet kontraktore ne zbatim te VKM Nr. 354, date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim".*

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik argumenton se në rastin konkret, nisur nga informacioni dhe dokumentacioni i detajuar i dhënë nga autoriteti kontraktor, kryesisht në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit, si edhe përcaktimin e vlerave minimale e maksimale të mbikëqyrjes, autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për zhvillimin e procedurës së prokurimit ka përcaktuar kritere dhe kushte të cilat janë detyrimisht të aplikueshme për cdo operator ekonomik të interesuar. Argumentat e autoritetit kontraktor, ofrojnë dhe hedhin dritë mbi fakte dhe rrethana të reja, të cilat në raste të tjera të ngjashme nuk kanë qenë të njohura më parë dhe që mund të kishin ndikim në vendimmarrjen e KPP. Qëllimi i VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” është që të mbrojë profesionet të cilat merren me planifikim territori, projektim, mbikëqyrje e kolaudim, pra lidhet me punën intelektuale që do të bëhen, duke dhënë një punë cilësore, por me një vlerë mbi minimumin e lejuar të përcaktuar me një vendim të posaçëm; Kjo VKM e posaçme ka për qëllim të zgjidhë situatën e vështirë të krijuar në afrimin dhe përzgjedhjen e personave fizikë, apo juridikë të interesuar, të kontraktohen për shërbimet e kërkuara, pasi shpesh ka rezultuar edhe me uljen e cilësisë së shërbimit të ofruar; Efekti i zbatimit të kësaj VKM është rritja e cilësisë së produktit të marrë në fushën e studimit, projektimit, drejtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit, nëpërmjet afrimit të profesionistëve të dalluar, duke përafruar nivelin e pagave që ato t’i përgjigjen realitetit të tregut të sotëm;

Gjithashtu, referuar edhe frymës së legjislacionit të posaçëm në fuqi, në rast se nuk zbatohet kjo VKM e cila ka dalë për qëllim të posaçëm për të mbrojtur punën intelektuale që bëhet në fushën e këtyre shërbimeve, atëherë kjo VKM nuk ka më asnjë vlerë dhe do të humbiste qëllimin për të cilin ka dalë për zbatim, sepse vetëm nëse do të mbeteshim tek argumentimi i analizës së kostos nëse ajo do të rezultonte anomalisht e ulët, atëherë kjo analizë do të ishte shumë subjektive, aq më tepër kur autoriteti kontraktor mund të kërkonte sqarime nga operatorët ekonomikë nëse pas aplikimit të formulës për ofertën anomalisht të ulët, mbi ofertat brenda kufijve ligjorë, do të rezultonte se një apo më shumë oferta janë anomalisht të ulta.

Autoriteti kontraktor sqaron se ai që në përlllogaritjen e fondit limit është bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe thekson se për shkak se 90% e objektit është i një vështirësie të madhe është zgjedhur grupi tarifar V.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, vlerësimi i ofertave është kryer duke aplikuar formulën për ofertën anomalisht të ulët referuar ligjit për prokurimin publik, dhe jo vlerave minimale, ndërkohë që BOE “Instituti Dekliada-Alb” sh.p.k. & “DERBI-E” sh.p.k. dhe BOE “E.B.S” sh.p.k. & “TAULANT” sh.p.k. kanë paraqitur oferta të papërgjegjshme dhe nën kufirin e përcaktuar nga legjislacioni i posaçëm në fuqi “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, e cila është e detyrueshme për të gjithë operatorët ekonomikë, pasi ky legjislacion nuk lë në diskrecionin e një autoriteti kontraktor të pranojë argumentat për elementët e veçantë të ofertës ekonomike të operatorëve, përsa kohë që ajo është jashtë kufijve minimalë dhe maksimalë të tarifave.

Sa më sipër, ofertat e paraqitura nga BOE “Instituti Dekliada-Alb” sh.p.k. & “DERBI-E” sh.p.k. dhe BOE “E.B.S” sh.p.k. & “TAULANT” sh.p.k. nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.1.6. Referuar shkresës nr.k-179/3prot., datë 09.03.2018 të autoritetit kontraktor, rezulton se vlera minimale e hartimit të projekt-preventivit për objektin “*Hartim i projekt-preventivit të objektit : "Furnizimi me ujë i Tiranës nga burimi i Gurit të Bardhë dhe shtimi i prodhimit të energjisë në Hecet"*” është në vlerën 28,832,769 lekë pa tvsh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit “ofertës ekonomike” BOE “Instituti Dekliada-Alb” sh.p.k. & “DERBI-E” sh.p.k. dhe BOE “E.B.S” sh.p.k. & “TAULANT” sh.p.k., rezulton se kanë ofertuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi përkatësisht: BOE “E.B.S” sh.p.k. & “TAULANT” sh.p.k. 19,800,000 lekë pa tvsh dhe BOE “Instituti Dekliada-Alb” sh.p.k. & “DERBI-E” sh.p.k. 25,599,999 lekë pa tvsh. KPP gjykon se vlerat e ofertuara nga bashkimet e operatorëve ekonomik të sipërcituar nuk janë në përputhje me VKM nr. Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, dhe rekomandimin e APP-së, pasi është shumë më e ulët se vlera minimale e përlllogaritur nga autoriteti kontraktor për realizimin e kësaj kontrate.

III.1.7. Referuar sa më sipër KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka vendosur tarifa minimale dhe maksimale për shërbimet e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të cilat duhet të mbahen në konsideratë nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në këto procedura. Komisioni sqaron se është detyrë e operatorëve ekonomikë të garantojnë që oferta e paraqitur të jetë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin në fjalë, BOE “Instituti Dekliada-Alb” sh.p.k. & “DERBI-E” sh.p.k. dhe BOE “E.B.S” sh.p.k. & “TAULANT” sh.p.k., kanë ofertuar me vlera të cilat rezultojnë të jenë nën vlerën minimale të lejuar të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor për kryerjen e këtij shërbimi.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “INVICTUS” sh.p.k & “C.E.C GROUP” sh.p.k & “LENI-ING” sh.p.k. qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të BOE ankimues lidhur me kualifikimin e ofertave të BOE “Instituti Dekliada-Alb” sh.p.k. & “DERBI-E” sh.p.k. dhe BOE “E.B.S” sh.p.k & “TAULANT” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë dhe gjendja e tyre faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtyre bashkimeve operatorësh ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e BOE “INVICTUS” sh.p.k & “C.E.C GROUP” sh.p.k & “LENI-ING” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Hartim i projekt-preventivit të objektit : "Furnizimi me ujë i Tiranës nga burimi i Gurit të Bardhë dhe shtimi i prodhimit të energjisë në Hecet*”, me nr. REF-31045-10-24-2017, me fond limit 32,000,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.11.2017, nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e BOE “Instituti Dekliada-Alb” sh.p.k. & “DERBI-E” sh.p.k. dhe BOE “E.B.S” sh.p.k & “TAULANT” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet duke i skualifikuar këto bashkime operatorësh ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “INVICTUS” sh.p.k & “C.E.C GROUP” sh.p.k & “LENI-ING” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 12 protokoli Datë 03.01.2018;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Kryetar
Evis Shurdha